REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.3408 Prot

Maliq, më 01.06.2026

VENDIM
Nr. 67, datë 29.05.2026

PËR

"DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.146 DATË 24.12.2025 "PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMNISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË MALIQ,PENALITETET DHE SHKELJET APO KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 dt 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 54 , "*Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak*" gërma "f", neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*" gërma "c", ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për proçedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë",* ligjit nr. 9632 dt 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 5 si dhe Vendimin nr. 146 datë 24.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Maliq, "*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, admnistrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2026*", Vkm nr 467 datë 31.07.2025 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme*" dhe Vkm nr.1156 datë 24.12.2020 "*Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre*", Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

I. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në Vendimim e Këshillit të Bashkisë nr.146, datë 24.12.2025 si më poshtë:

I.1 Në kreun 9 "Tarifa të ndryshme në Bashki", pika VI të shtohen zërat e mëposhtëm:

Dhen(në zona të mbrojtura)	Lekë/krerë/vit	100
Dhi (në zona të mbrojtura)	Lekë/krerë/vit	250
Gjedhë (në zona të mbrojtura)	Lekë/krerë/vit	500
Njëthundrakë (në zona të mbrojtura)	Lekë/krerë/vit	600
Park fotovoltaik deri 10 ha, deri 10 vjet	Lekë/vit	192 000
Park fotovoltaik deri 10 ha, mbi 10 vjet	Lekë/vit	173 000

Park fotovoltaik mbi 10 ha, deri 10 vjet	Lekë/vit	156 000
Park fotovoltaik mbi 10 ha, mbi 10 vjet	Lekë/vit	132 000
Aerogjenerator deri 10 ha, deri 10 vjet	Lekë/vit	120 000
Aerogjenerator deri 10 ha, mbi 10 vjet	Lekë/vit	100 000
Aerogjenerator mbi 10 ha, deri 10 vjet	Lekë/vit	90 000
Aerogjenerator mbi 10 ha, mbi 10 vjet	Lekë/vit	70 000
Objekte ndihmëse për barinjtë	Lekë/m2/vit	150

I.2 Në kreun 9 "Tarifa të ndryshme në Bashki", pika VI të ndryshohen zërat e mëposhtëm:

Dhen	Lekë/krerë/vit	100	Lekë/krerë/vit	200
Dhi	Lekë/krerë/vit	80	Lekë/krerë/vit	250
Gjedhë	Lekë/krerë/vit	800	Lekë/krerë/vit	1000
Njëthundrak	Lekë/krerë/vit	800	Lekë/krerë/vit	1200
Qendër stani e rrethuar	Lekë/m2/vit	50	Lekë/m2/vit	100
Qendër përpunim bulmeti	Lekë/m2/vit	100	Lekë/m2/vit	150
Ngrehinë banimi për barinjtë	Lekë/m2/vit	50	Lekë/m2/vit	50

I.2 Në kreun 9 "Tarifa të ndryshme në Bashki", pika VI të hiqen zërat e mëposhtëm:

Dhen (në pyll)	Lekë/krerë/vit	50
Dhi (në pyll)	Lekë/krerë/vit	100
Gjedhë (në pyll)	Lekë/krerë/vit	60
Njëthundrak (në pyll)	Lekë/krerë/vit	60

II. Tek kreu B, tarifat vendore, tek pika II.2 Biznes i madh të shtohen zërat:

Kategoritë	Tarifa pastrim	Tarifa ndriçim	Tarifa gjelbërim
Për çdo njësi rishitëse	20 000 Lekë/vit	2 000 lekë/vit	1 500 lekë/vit

III. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të bëjë ndryshimet në buxhetin e bashkisë për vitin 2026.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore dhe Sektori i Pyjeve dhe Kullotave.

V. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar.

Miratuar me 18 vota
Vota Pro 18
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI